



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes propozon:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, nenit 9 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane Nr. 15-020-63687 të datës 24.09.2019 dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_2022 të miratojë këtë :

### PROPOZIM

#### VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR KOORDINIMIN E PROCESIT TË ZGJEDHJEVE TË KËSHILLAVE LOKALE

#### Neni 1

#### Përbërja e Komisionit

Me këtë Vendim formohet Komisioni për koordinimin e procesit të zgjedhjeve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit në përbërje si vijon:

1. \_\_\_\_\_ nga subjekti politik LDK, Kryesues
2. \_\_\_\_\_ nga subjekti politik LDK, anëtar
3. \_\_\_\_\_ nga subjekti politik PDK, anëtar
4. \_\_\_\_\_ nga subjekti politik LVV, anëtar
5. \_\_\_\_\_ nga ekzekutivi i Komunës, anëtar
6. \_\_\_\_\_ nga shoqëria civile, anëtar
7. Përfaqësues nga fshati, vendbanimi apo lagja urbane nga lokaliteti ku bëhet zgjedhja e këshillit lokal, anëtar

#### Neni 2

#### Mandati i anëtarëve

Mandati i Komisionit është i lidhur me me mandatin e Kuvendit të Komunës.

### **Neni 3**

#### **Detyrat e Komisionit**

Komisioni Komunal ka për detyrë të vazhdojë organizimin e zgjedhjen e të këshillave dhe kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane i cili organizim ishte pezulluar përshkak të situatës me pandemi si dhe të kryej detyra tjera të përcaktuara me dipozitat e Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane Nr. 15-020-63687 të datës 24.09.2019.

### **Neni 4**

#### **Kompensimi i punës së komisionit**

Për punën e tij Komisioni do të kompensohet në vlerë prej 30 € (tridhjetë euro) për pjesëmarrje në secilin takim të mbajtur në fshatin, vendbanimin apo lagjen urbane i cili do të evidentohet në procesverbal. Pagesa do të bëhet nga buxheti i Komunës –kategoria ekonomike- mallra dhe shërbime.

### **Neni 5**

#### **Punët administrative - juridike të Komisionit**

Punët administrative - juridike të Komisionit do ti kryej Drejtorati për Administratë - Sektori për punë të Kuvendit dhe të Komiteteve.

### **Neni 6**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

### **Arsyetim**

Baza juridike për të miratuar këtë Propozim- Vendim është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, nenit 9 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane Nr. 15-020-63687 të datës 24.09.2019 dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit .

Komisioni Komunal ka për detyrë të vazhdojë të organizojë zgjedhjen e këshillave dhe kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të cilat aktivitetet ishin ndërprerë – pezulluar për shkak të situatës së krijuar me Pandeminë Covid-19 ku ndalohej mbajtja e tubimeve publike si dhe të kryej detyra tjera të përcaktuara me dipozitat e Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane Nr. 15-020-63687 të datës 24.09.2019.

Nga të cercura më lartë , kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 1-020/02-14270  
Lipjan, 16.03.2022

